

**AKT THEMELIMI**  
**“Eureka Food & Beverage Company Limited” SH.P.K**  
(Shoqëri me ortak të vetëm)

Sot, më datë 26.07.2021, (dymijë e njezetë e një) në Tiranë:

1. **Z. Elvis Balla**, i datëlindjes 31.08.1993, shtetas shqiptar, lindur në Prrenjas, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën e Republikës së Shqipërisë me Nr. BJ6932046

Me anë të këtij Akti Themelimi, themelon një shoqëri të zotëruar tërësisht prej saj, në Republikën e Shqipërisë, si vijon:

**1. THEMELIMI**

- 1.1 Themelimi në Republikën e Shqipërisë të shoqërisë me emër **“Eureka Food & Beverage Company Limited” Sh.p.k** (“Shoqëria”). Ky emërtim do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.
- 1.2 **“Eureka Food & Beverage Company Limited” Sh.p.k** është një shoqëri tregtare dhe person juridik shqiptar, e organizuar ligjërisht si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k), në përputhje me ligjet e Shqipërisë dhe dispozitat e statutit aktual të saj (**“Statuti”**).
- 1.3 Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Lagja nr. 13 Shkembi Kavajes, Kati 0, dhoma 6, Durres, Shqipëri. Shoqëria rezervon të drejtën të transferojë selinë e saj në një adresë dhe /apo në një qytet tjeter të Shqipërisë.
- 1.4 Më vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 1.5 Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar duke nisur nga regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**2. OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 2.1 Objekti i Shoqërisë është si vijon: Bar-Restorant Aziatik. Për tu ofruar klientëve tanë ushqimet më të mira tradicionale të kuzhinës aziatike dhe për tu shërbyer atyre me recetat më të veçanta nëpërmjet importimit të përbërësve ushqimore të ndryshëm nga vende të ndryshme aziatike dhe nëpërmjet punësimit të specialisteve më të mirë të specializuar në kuzhinën aziatike.
- 2.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërmendor, shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti tjeter që konsiderohet i përshtatshëm apo i nevojshëm për përbushjen e objektit të shoqërisë.



### **3. KAPITALI THEMELTAR**

- 3.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë e përbërë nga 1 (një) kuotë e vetme e zotuar tërësisht nga Ortaku i vetëm, **Z. Elvis Balla**, i datëlindjes 31.08.1993, shtetas shqiptar, lindur në Prrenjas, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën e Republikës së Shqipërisë me Nr. BJ6932046

### **4. ORGANET VENDIMARRËSE TË SHOQËRISË**

- 4.1 Organet vendimarrëse të Shoqërisë janë:
- i. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve,
  - ii. Administratori

### **5. ASAMBLEJA E PËRGJITHSME E ORTAKËVE**

- 5.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, e cila përbëhet nga ortaku i vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, i cili merr vendime mbi aktivitetin dhe politikën ekonomike dhe tregtare të saj.

### **6. ADMINISTRATORI**

- 6.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator, i cili do të jetë përfaqësues ligjor i shoqërisë dhe përfaqëson atë kundrejt palëve të treta dhe do të jetë përgjegjës për menaxhimin e çështjeve të përditshme të shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në statutin e shoqërisë dhe në ligjin e aplikueshëm.

- 6.2 Administrator i shoqërisë është:

**Z. Elvis Balla**, i datëlindjes 31.08.1993, shtetas shqiptar, lindur në Prrenjas, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me pasaportën e Republikës së Shqipërisë me Nr. BJ6932046, i cili ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e tij pa kufizim.

- 6.3 Kohëzgjatja e emëritimit të administratorit të Shoqërisë do të jetë 5 (pesë) vjet, nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (“QKB”), me të drejtë ripërtëritje.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale identike në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues. Çdo mosmarrëveshje që lind në zbatimin dhe/ose interperimin e këtij Akti Themelimi, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

#### **PËR ORTAKUN E VETËM**

**Elvis Balla**

*Elvis Balla*  
*E Balla*